



Bringing the Convention closer to home  
La Convention à votre porte

## Pranueshmëria e një ankimi<sup>1</sup>

1. Formulari i ankimit dhe Neni 47 i Rregullores së Gjykatës .....	1
2. Shterimi i mjeteve juridike në nivel kombëtar dhe afati kohor gjashtë mujor (Neni 35 § 1 i Konventës).....	2
3. Abuzimi apo keqpërdorimi i të drejtës së ankimit (Neni 35 § 3 i Konventës).....	3
4. Kërkesa që janë dorëzuar ndërkohë në Gjykatë ose në ndonjë institucion tjetër ndërkombëtar (Neni 35 § 2 i Konventës).....	3
5. Statusi i viktimës (Neni 34 i Konventës).....	3
6. Detyrimi i Shtetit ( <i>Ratione personae</i> ) (Neni 35 § 3 i Konventës) .....	4
7. Juridiksioni territorial ( <i>Ratione loci</i> ) (Neni 35 § 3 i Konventës) .....	4
8. Juridiksioni kohor ( <i>Ratione temporis</i> ) (Neni 35 § 3 i Konventës).....	4
9. Objekti i çështjes ( <i>Ratione materiae</i> ) (Neni 35 § 3 i Konventës) .....	5
10. Mungesa e një dëmi të konsiderueshëm (Neni 35 § 3 (b) i Konventës) .....	5
11. Kërkesa haptazi të pabazuara (Neni 35 § 3 i Konventës).....	5
12. Komente përfundimtare .....	6

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut refuzon rreth 90% të kërkesave që merr, duke i gjykuar ato si të papranueshme. Nga kjo statistikë ashtu si edhe nga praktika e GJEDNJ-së, del se shumica e individëve dhe e këshilltarëve ligjorë që paraqesin kërkesa në GJEDNJ kanë nevojë për njohuri më të mira rreth kritereve të pranueshmërisë.

### 1. Formulari i ankimit dhe Neni 47 i Rregullores së Gjykatës

Që kërkesa juaj të deklarohet e pranuar për shqyrtim të mëtejshëm nga Gjykata, para së gjithash ju duhet të plotësoni të gjithë informacionin që kërkohet në Formularin e Ankimit. Ju duhet të parashtroni një përmbledhje të çështjes suaj; të plotësoni pjesën e formularit ku listohen shkeljet e Konventës dhe të nënshkruani në fund të formularit. Gjithashtu, ju duhet t'i bashkangjisni formularit të gjitha dokumentet e rëndësishme mbështetëse, si p.sh. vendimet e gjykatave kombëtare.

Kërkesa juaj nuk duhet të jetë anonime.

<sup>1</sup> © Këshillit të Evropës/ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2015  
Përmbajtja e këtij teksti nuk është detyrues për Gjykatën.

Ju duhet të shkruani emrin tuaj në kërkesë në mënyrë që të jeni të identifikueshëm.

Në rast se nuk dëshironi të bëni publik identitetin tuaj, ju mund ta bëni një kërkesë të tillë ose në formularin e ankimit ose në një kohë sa më të shkurtër pas depozitimit të kërkesës. Për këtë, ju duhet të përmendni arsyet për mospublikimin e identitetit tuaj dhe të shpjegoni se si zbulimi i identitetit mund t'ju dëmtojë, apo të ndikojë tek ju. Këtë vendim mund ta marrë vetëm Gjykata. Nëse ju lejohet anonimiteti, juve duhet t'ju referohen sipas iniciaveleve tuaja apo thjesht përmes një gërme. Nëse jo, emri juaj do të shfaqet në të gjitha dokumentet që Gjykata publikon online në bazën e saj të të dhënave HUDOC.

Lutemi të mbani në konsideratë faktin se të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me Nenin 47 të rregullores së Gjykatës mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës tek nëntitulli "Ankimi"<sup>2</sup>.

## **2. Shterimi i mjeteve juridike në nivel kombëtar dhe afati kohor gjashtë mujor (Neni 35 § 1 i Konventës)**

---

Ju duhet të dorëzoni formularin e plotësuar të kërkesës/ankimit përpara përfundimit të afatit të detyrueshëm kohor prej gjashtë muajsh. Vetëm dorëzimi i formularit të plotësuar të kërkesës ndërpret kalimin e afatit gjashtë mujor.

Ju duhet ta dërgoni ankimin tuaj me postë sa më shpejt që është e mundur, gjithmonë brenda afatit gjashtë mujor. Ky afat fillon që nga data kur është dhënë vendimi përfundimtar në nivel kombëtar, vendim që tregon se ju keni shteruar të gjitha mjetet ankimore ligjore në nivel të brendshëm. P.sh., nëse data e vendimit përfundimtar në nivel kombëtar është 20 Janari, ju duhet ta dërgoni formularin e ankimit jo më vonë se mesnata e datës 20 Korrik. Ky afat kohor nuk ndryshon edhe në rast se dita e fundit e afatit gjashtë mujor përfundon në një ditë të shtune, të diel, apo në një festë zyrtare.

Ju lutemi të keni parasysh që sapo të hyjë në fuqi Protokollin nr. 15 i KEDNJ-së, afati kohor prej gjashtë muajsh reduktohet në katër muaj.

Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike në nivel kombëtar, ju duhet të shfrytëzoni të gjitha mjetet ligjore në Shtetin tuaj që mund të çojnë në zgjidhjen e situatës apo mosmarrëveshjes për të cilën ankoheni. Një gjë e tillë konsiston në një padi të ngritur në një gjykatë civile, penale apo administrative, të pasuar nga apelimi i vendimit të dhënë nga këto gjykata kur është rasti, madje edhe një rekurs në një gjykatë më të lartë, si p.sh. Gjykatë e Lartë apo Gjykatë Kushtetuese, nëse një e tillë ekziston.

Veç kësaj, juve duhet t'u përmbaheni rregullave dhe procedurave të akteve ligjore në fuqi në nivel kombëtar. Nëse çështja juaj nuk ka gjetur zgjidhjet nga gjykatat kombëtare sepse ju nuk e keni ngritur kërkesë padinë brenda afatit ligjor të parashikuar nga legjislacioni kombëtar, atëherë ankesa juaj drejtuar Gjykatës së Strasburgut mund të shpallet e papranueshme.

Dhe së fundmi, kur shqyrtohet çështja apo mosmarrëveshja nga gjykatat kombëtare, mbani parasysh që duhet të parashtroni edhe përpara këtyre institucioneve të paktën thelbin e shkëljes së Konventës, që e pretendoni më pas në GJEDNJ.

---

<sup>2</sup> <http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=applicants/sqi&c=>

### **3. Abuzimi apo keqpërdorimi i të drejtës së ankimit (Neni 35 § 3 i Konventës)**

---

Kërkesa juaj mund të shpallet e papranueshme për shkelje të së drejtës për t'u ankuar apo paraqitur kërkesë.

Një rast i tillë është kur ju mashtroni Gjykatën duke dorëzuar një kërkesë me emër fals apo të paqenë ose duke falsifikuar dokumente të caktuara; ose kur ju nuk e informoni gjykatën për një zhvillim të rëndësishëm në çështjen tuaj që është thelbësor për shqyrtimin e saj ose për ndonjë zhvillim të ri që mund të ketë ndodhur gjatë kohës kur çështja juaj procedohej para Gjykatës së Strasburgut, siç mund të jetë rasti i një vendimi të dhënë në favorin tuaj.

Kërkesa juaj mund të shpallet e papranueshme nëse ju përdorni gjuhë abuzuese, siç mund të jetë fyerja ose nëse shkelni detyrimin e konfidencialitetit në negociatat për zgjidhje miqësore apo jashtë gjyqësore të mosmarrëveshjeve.

### **4. Kërkesa që janë dorëzuar ndërkohë në Gjykatë ose në ndonjë institution tjetër ndërkombëtar (Neni 35 § 2 i Konventës)**

---

Kërkesa juaj mund të shpallet e pa-pranueshme nëse Gjykata e Strasburgut ka shqyrtuar një kërkesë të dorëzuar nga ju më parë, që ka të bëjë me të njëjtat fakte dhe të njëjtën mosmarrëveshje.

E njëjta gjë vlen edhe për një kërkesë që në thelb është e njëjtë me çështjen që keni ngritur në një institution tjetër ndërkombëtar siç është Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara.

### **5. Statusi i viktimës (Neni 34 i Konventës)**

---

Ju mund të pretendoni një shkelje vetëm nëse jeni viktimë e asaj shkeljeje.

Ju mund të jeni viktimë e drejtpërdrejtë; p.sh. nëse jeni viktimë e keqtrajtimit në burg dhe gjykata kombëtare nuk e ka pranuar ose nuk e ka dënuar një gjë të tillë, apo nëse nuk keni marrë dëmshpërblimin e mjaftueshëm.

Ju mund të jeni viktimë e tërthortë. Kështu mund të jetë rasti, për shembull, nëse viktima e drejtpërdrejtë vdes përpara se të dorëzojë një kërkesë në Gjykatën e Strasburgut dhe ju keni interes ligjor si personi më i afërt me lidhje gjaku për t'u ankuar lidhur me vdekjen ose zhdukjen e të afërmit tuaj. Megjithatë, nëse kërkesa juaj nuk është ngushtësisht e lidhur me vdekjen ose zhdukjen e tij, statusi juaj si viktimë mund t'u mohohet.

Ju mund të jeni një viktimë e mundshme; p.sh., nëse jeni një i huaj për të cilin është urdhëruar largimi nga vendi, vendim që ende nuk është ekzekutuar, ndërkohë që largimi do të mund t'ju ekspozonte para trajtimit çnjerëzor ose degradues, ose torturës në shtetin pranues.

Dhe së fundi, kur viktima vdes gjatë kohës kur zhvillohet procesi gjyqësor para Gjykatës së Strasburgut, në rast se jeni trashëgimtar ose i afërt i tij/saj, ju mund ta vazhdoni procesin nëse tregoni një interes legjitim për një gjë të tillë.

## **6. Detyrimi i Shtetit (*Ratione personae*) (Neni 35 § 3 i Konventës)**

---

Shkelja ndaj së cilës ju ankoheni duhet të jetë kryer nga Shteti i paditur ose në një farë mënyre duhet t'i atribuohet atij.

Kërkesa juaj mund të shpallet e papranueshme, në lidhje me palën e paditur:

- nëse është dejtuar kundër një individ;
- nëse është drejtuar kundër një shteti që nuk e ka ratifikuar Konventën ose Protokollet e saj;
- ose nëse është drejtuar drejtpërsëdrejti kundër një organizate ndërkombëtare, siç janë institucionet e Bashkimit Evropian, të cilat ende nuk kanë aderuar në Konventë. Megjithatë, nëse ankesa juaj drejtohet kundër Shteteve Anëtare të BE-së lidhur me zbatimin nga ana e tyre të së drejtës së BE-së, kërkesa juaj mund të pranohet nga Gjykata.

Ju mund të paraqesni një kërkesë nëse jeni një individ, nëse jeni një organizatë jofitimprurëse, si p.sh. një organizatë apo shoqatë, ose nëse jeni një kompani private.

Ju mund të paraqisni një kërkesë pavarësisht nga kombësia juaj, statusi juaj i imigrimit apo zotësia juaj juridike.

## **7. Juridiksioni territorial (*Ratione loci*) (Neni 35 § 3 i Konventës)**

---

Shkelja kundër së cilës ankoheni duhet të ketë ndodhur brenda juridiksionit territorial të Shtetit Anëtar në fjalë ose një territori që kontrollohet efektivisht prej tij.

Kështu, një Shtet i paditur mund të jetë përgjegjës për veprimet e stafit të tij diplomatik dhe konsullor jashtë vendit në kontekst të një misioni diplomatik, ku ata kanë autoritet dhe ushtrojnë kontroll mbi individë jashtë territorit të Shtetit.

## **8. Juridiksioni kohor (*Ratione temporis*) (Neni 35 § 3 i Konventës)**

---

Aktet ose faktet kundër të cilave është paraqitur ankesë duhet të kenë ndodhur pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës në Shtetin e paditur.

Megjithatë, kërkesa juaj mund të pranohet nëse ka të bëjë me një gjendje të vazhdueshme që ka filluar para ratifikimit dhe ka vazhduar pas asaj date; p.sh. Gjykata u shpreh se kishte juridiksion për të vendosur mbi zhdukjen e personave që kishin ndodhur rreth trembëdhjetë vjet përpara se Shteti i paditur të kishte njohur të drejtën e individëve për të paraqitur kërkesa individuale në Gjykatë. Në të vërtetë, një zhdukje nuk është veprim ose ngjarje e "menjëhershme". Ndaj, detyra procedurale për të hetuar vazhdon potencialisht për aq kohë sa fati i personit të zhdukur nuk është vendosur, edhe në rastet kur mund të prezumohet vdekja e tij.

## **9. Objekti i çështjes (*Ratione materiae*) (Neni 35 § 3 i Konventës)**

---

Ju duhet të përcaktoni dhe identifikoni qartë një të drejtë që garantohet nga Konventa ose Protokollet e saj, si p.sh. e drejta e jetës ose e drejta për një mjet ankimor efektiv. Kërkesa juaj mund të hidhet poshtë si e papajtueshme për arsye që lidhen me përmbajtjen apo objektin e çështjes – p.sh. ju kërkon të drejtën që të pajiseni me patentë shoferi, ose të drejtën për të hyrë apo banuar në një Shtet kontraktues, edhe nëse nuk jeni shtetas i atij vendi.

Kërkesa juaj duhet të jetë brenda qëllimit të zbatimit të së drejtës të cilën e pretendoni, siç është e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta për jetë private dhe familjare, e drejta për mbrojtjen e pronës. Kështu, p.sh. garancitë për një proces të rregullt ligjor të Nenit 6 të Konventës nuk vlejnë për proceset gjyqësore të azilit ose dëbimit, ose për shumicën e proceseve gjyqësore që kanë të bëjnë me taksat.

## **10. Mungesa e një dëmi të konsiderueshëm (Neni 35 § 3 (b) i Konventës)**

---

Kërkesa juaj mund të shpallet e papranueshme nëse nuk keni pësuar ndonjë dëm të konsiderueshëm.

Kjo mund të ndodhë për shkak të elementit të parëndësishëm financiar të kërkesës suaj - kështu, p.sh. nëse ankoheni rreth mosekzekutimit të një vendimi për një vlerë prej 34 Euro ose për vonesa në pagimin e pagës prej 200 Euro. Cënimi i një të drejte duhet të arrijë një nivel minimal të rëndësisë për ta justifikuar shqyrtimin nga një gjykatë ndërkombëtare.

Megjithatë, ekzistojnë dy klauzola mbrojtëse brenda këtij kriteri: së pari: kur respekti për të drejtat e njeriut kërkon një shqyrtim bazuar në themelin e çështjes. Kështu, në një çështje, ku shuma e diskutuar ishte vetëm 17 Euro, Gjykata konsideroi se duhej një vendim që parashtronte parimet pasi kjo ishte çështja e parë pas një amendimi të ligjeve kombëtare.

Klauzola e dytë mbrojtëse kërkon që çështja juaj të jetë shqyrtuar në mënyrën e duhur nga një gjykatë kombëtare. Kështu, në një çështje Gjykata e shpalli një kërkesë për shumën 70 Euro si të pranueshme pasi legjislacioni i brendshëm nuk siguronte një mjet korrigjues efektiv.

Ju lutemi të mbani parasysh që pas hyrjes në fuqi të Protokollit 15, klauzola e dytë mbrojtëse hiqet.

## **11. Kërkesa haptazi të pabazuara (Neni 35 § 3 i Konventës)**

---

Kërkesa juaj mund të shpallet haptazi e pabazuar edhe kur të gjitha kriteret formale të pranueshmërisë të përmendura më sipër janë përmbushur. Ky është rasti kur kërkesa juaj nuk paraqet asnjë lloj forme shkeljeje, dhe kur ekziston një praktikë gjyqësore e konsoliduar me precedentë të shumtë gjyqësorë për raste të ngjashme ose identike me kërkesën tuaj, kur nuk gjendet asnjë shkelje e Konventës.

Kërkesa juaj mund të jetë haptazi e pabazuar nëse ju nuk keni arritur të siguronit prova të mjaftueshme për të mbështetur faktet dhe argumentet ligjorë që keni ngritur, p.sh. rasti kur nuk arrini të shpjegoni pse është shkelur një nen i Konventës.

Kërkesa juaj mund të shpallet e papranueshme nëse ajo është aq e ngatërruar saqë mund të jetë e pamundur për Gjykatën që ta kuptojë ankimin që keni bërë. E njëjta gjë vlen për ankimet që duken haptazi të sajura ose janë në kundërshtim me logjikën e zakonshme.

Së fundmi, Gjykata e Strasburgut nuk është gjykatë e "shkallës së katërt", ajo nuk është gjykatë apeli, ose gjykatë e rishikimit apo gjykatë kasacioni. Ajo nuk mund të vërë në dyshim vërtetimin e fakteve nga gjykatat kombëtare në çështjen tuaj, as vlerësimin e tyre apo zbatimin e së drejtës kombëtare, e as fajësinë ose pafajësinë në një çështje penale.

## 12. Komente përfundimtare

---

Proceset gjyqësore para Gjykatës së Strasburgut janë pa pagesë. Ju nuk keni nevojë të përfaqësoheni nga një avokat të paktën në fazat fillestare, dhe mund ta dorëzoni kërkesën në një nga gjuhët e Shteteve Anëtare.

Lutemi të mbani parasysh se nuk ka procedurë ankimi kundër vendimit që ka shpallur kërkesën tuaj të papranueshme. Nëse çështja juaj është qartazi e papranueshme, Gjykata do t'ju njoftojë në kohën e duhur. Nëse kërkesa juaj pranohet, Gjykata më pas do të vazhdojë të gjykojë nëse janë shkelur ose jo të drejtat e Konventës.

Vendimet e Gjykatës publikohen në bazën e saj të të dhënave HUDOC<sup>3</sup>.

Në mënyrë që të keni shanset më të mira që kërkesa juaj të pranohet nga Gjykata, ju lutemi të mbani parasysh të gjitha kriteret e pranueshmërisë që u përmendën më sipër. Mos ngurroni të shfrytëzoni bazën e të dhënave HUDOC të Gjykatës si dhe faqen e saj të internetit, apo dhe publikime të tjera të postuara nga Gjykata, siç është Udhërrëfyes praktik për pranueshmërinë<sup>4</sup> që gjendet online në faqen e Gjykatës.

---

<sup>3</sup> <http://hudoc.echr.coe.int/>

<sup>4</sup> [http://www.echr.coe.int/Documents/Admissibility\\_guide\\_SQL.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Admissibility_guide_SQL.pdf)